



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3247 / Prot

2

Datë 23/12 2022

VENDIM

Nr. 68, datë 22/12 2022

MBI

**“TARIFËN E SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE  
AKADEMIKE, TË DOKTORATËS NË UNIVERSITETIN E TIRANËS”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në nenin 3, pika 3, gërma ç), nenin 49, pikat 1, gërma a), dhe ë), nenin 79, pika 5, nenin 98, pika 2, gërma c), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” seksioni IV, neni 7, pika 3/ç), Statutin e Universitetit të Tiranës neni 7, pika 3, gërma ç), neni 55, pika 1, gërma a), neni 98, 99, Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës nr. 16, datë 26.04.2021, Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 11, datë 27.04.2021, Vendimin e Senatit Akademik nr. 34, datë 23.11.2022. Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 22.12.2022,

**VENDOSI:**

1. Për kandidatët që kanë fituar të drejtën për të ndjekur programe studimi të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës në njësitë kryesore, të cilët janë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës, tarifa e shkollimit përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit,
2. Për kandidatët që vijnë nga jashtë Universitetit të Tiranës, tarifa përballohet nga vetë kandidati ose nga institucioni që mbështet kërkimin shkencor sipas një marrëveshje paraprake midis tyre,
3. Ngarkohet Administratori UT-së me strukturat përkatëse administrative pranë Rektoratit dhe në fakultete, të marrë masat e nevojshme për procedurat e mëtejshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi,
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

  
KRYETARI  
ADELA KARAPICI